

Nr.regj. 16960/2010

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep	
Dep	DPK/DMP
Nr. llog	
Broj stranica	02
Nr. pages	
Nr. Prot	
Br. Prot.	03-1108/2012
Prot. No.	
Crta	
Datum	19.03.2012
Date	

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën e rivendosjes së çështjes kundërvajtëse kundër të pandehures Miradije Meha nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 6.2 e ndëshkuar me nenin 16 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik e Pasurisë, Nr. 03/L-151, në bazë të nenit 73,74, 195,199 dhe nenit 227 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZK 23/79, me datë **02.02.2012** merr këtë:

AKTVE N D I M

E PANDEHURA: Miradije (Zeqir) Meha, e lindur në vitin 1958 në fshatin Orllat, Komuna Podujevë, tani jeton në Prishtinë, me vendbanim në lagjen Dardania rruga "Musene Kokollari" nr.14, Kryesuse e Departamentit të Administratës së Përkrahjes në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, e martuar, me shkollim superior, e gjendjes së mesme ekonomike,

Ë s h t ë P ë r g j e g j ë s e

Sepse, si zyrtare e lartë në pozitë të Kryesuses së Departamentit të Administratës dhe Përkrahjes në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nuk ka bërë deklarin e rregullt vjetor të gjendjes së pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsion, brenda afatit ligjor deri më datën **31.03.2010**

- **me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 6.2 e ndëshkuar me nenin 16. Paragrafi 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik**, andaj për këtë i shqiptohet,

D Ë N I M I

Me gjobë në shumë prej 300 € (trqindeuro), të cilën shumë e pandehura është e obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të merr formë e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së No.1000 4300 7000 0518. PAGESA bëhet në ndonjërin agjenci për mbledhjen e të hyrave-bankë, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta*do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **20 ditësh**, duke llogaritur nga 15 euro për një ditë burgimi.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqësor e pandehura është e obliguar të paguaj shumë prej **10 Euro** në shërbimin e arkës së gjykatës.

Nga një kopje e këtij aktvendimi ti dërgohet parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsion në Prishtinë, i parashtrori kësaj gjykate Kërkesën 01/2289/2010 me datë 15.06.2010 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurës së lartshënuar për kundërvajtje të precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, meqë e njëjta në Agjencinë kundër Korrupsion nuk e ka dorëzuar formularin mbi deklarin e rregullt vjetor të gjendjes së pasurisë deri më datën 31.03.2010.

Duke vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje, gjyqtarja në procedurën e rivendosjes ka bërë eliminimin e pakjartësisë që ka të bëjë me datën e shënuar në dispozitiv të aktvendimit të abroguar të nxjerrë me datë 14.07.2011, ashtu që në vend të datës "31.03.2011" shënoi datën korrekte "31.03.2010", siç precizohet edhe në dispozitiv të këtij aktvendimi.

03-1108/2012/02
Suzana

Në procedurën e rigjykimit, gjyqtarja sërish dëgjoi të pandehuren e ci cila në mbrojtjen e vet mbeti pranë pretendimeve të saja ankimore duke shtuar se ka qenë në dijeni për çështjen e deklarimit të pasurisë, por nuk e ka bërë deklarimin e pasurisë për shkak të angazhimeve me punë në KQZ, për shkak në bisedë me kolegë ka vlerësuar se si shërbyese civile nuk ka nevojë të bëjë deklarimin e pasurisë dhe për shkak se edhe bashkëshorti i saj e kishte bërë deklarimin e pasurisë, ku ishte përfshirë emri i saj, andaj e kishte vlerësuar si nuk është e obliguar që edhe vet të deklarojë pasurinë.

Sa i përket pretendimit ankimor, përkatësisht vërtetimit të faktit se e pandehura i përket apo jo kategorisë së zyrtarëve të lartë, gjyqtarja këtë fakt e ka konstatuar në bazë të listës së prezantuar nga vet KQZ në Agjencinë Kundër Korrupsion në të cilën figuron edhe emri i të pandehurës Miradije Meha. Ndërsa sa i përket faktit tjetër ankimor se e pandehura nuk ka pasur obligim të bëjë deklarimin pasurisë meqë bashkëshorti i saj e ka bërë deklarimin e pasurisë për të njëjtën periudhë, gjyqtarja vlerësoi se me asnjë dispozitë ligjore përkatëse nuk parashihet se njëri bashkëshort është i liruar nga ky obligim nëse bashkëshorti tjetër bënë deklarimin e pasurisë.

Gjatë zhvillimit të procedurës së rigjykimit gjyqtarja nuk gjeti veprim tjetër kontestues, që kërkon të vërtetohet me prova të reja, rivendosi çështjen sërish duke vërtetuar gjendjen e njëjtë faktike, konstatoi se e pandehura nuk ka respektuar dispozitën ligjore gjegjëse sipas së cilës ka qenë e obliguar të deklarojë pasurinë deri më 31.03.2010 dhe sërish mori aktvendim ndëshkues, të pandehuren e shpalli përgjegjëse dhe i shqiptoi dënimin e paraparë ligjor.

Gjatë shqiptimit të dënimit, gjyqtarja pati parasysh rrethanat nga neni 7 i LK në të cilat është kryer kundërvajtja dhe duke vlerësuar peshën e kundërvajtjes, masën dhe kohën e shkeljes, shkallën e përgjegjësisë sipas pozitës së zyrtares së lartë publike, të njëjtën e dënoi me gjobën e precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, me bindje se edhe me një gjobë të tillë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit dhe se e pandehuri nuk do të përsëris vepër të tillë apo të ngjashme kundërvajtëse .

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

Nr.regj.16960/2010, datë 02.02.2012

Gjyqtarja
Suzana Çerkim



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh nga data e pranimit të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.